

2 Zeja e floktarisë dhe e karrocerisë KKP më të mira dhe paga më të larta

3 Mbi demokracinë dhe rolin e Unia Bisedë me Hilmi Gashin, drejtues i grupeve të interesit

4 Marrëveshja pensionale Zvicër-Shqipëri Përfitime të ndërsjellta nga Sigurimet Shoqërore

Nr. 5 | Shtator 2022 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Gratë dhe familjet nën presion financiar

2x JO: Shkurtimeve të pensioneve të AHV/AVS; Ngritjes së TVSH

26 000 Franken weniger Rente?

**AHV-Abbau
2x NEIN**

Mehr bezahlen, weniger Rente



26000 franga më pak dhe reduktim pensionesh, duhet qartas të merrë JO të dyfishtë në votimet e 25 shtatorit 2022!

Përmes AHV/AVS 21 blloku i të djathtës borgjeze donë që të shkurtohen pensionet solidare të AHV/AVS në kurriz të grave. Janë të prekur gjithashtu burrat dhe familjet. Tani nevojitet një Jo e dyfishtë shkurtimeve të pensioneve të AHV/AVS.

Brigitta Bernet, specialiste e çështjeve politike në Unia

Shkurtimeve sociale po shpërfaqet si një hobi fëmijëror i borgjezëve dhe neoliberalëve në të gjithë Evropën. Aktualisht kjo po prek sigurimin e pleqërisë, ku përmes privatizimit mund të harxhojë miliarda. Në Zvicër këto forca janë bërë bashkë në propozim ligjin reduktues AHV/AVS 21, për të cilin ne do të votojmë me 25 shtator. Kjo reformë synon të rritë të dyja: Moshën e pensionimit të grave në 65 vjeç dhe TVSH-në (Tatimin në Vlerën e Shtuar) për 0,4%. Edhe pse gratë aktualisht marrin një të tretën (1/3) më të ulët të pensioneve, në dhjetëvjeçarët e ardhshëm pensionet e tyre do të shkurtohen për 7 miliarda franga. Kështu gratë në të ardhmen secila grua do të humbë rreth 26000 franga të ardhura në vit.

Jo përkeqësimit të mëtejshëm të situatës së pensioneve të grave

Problemet e vërteta, me të cilat përballen në përditshmëri shumë pensionistë, janë pensionet tejet të ulëta. Shpesh shuma e pensioneve nuk mjafton për

një jetë të mirë – posaçërisht për gratë. Pasi ato shumë herë marrin përsipër punët e vështira – mirëpo edhe të paguara keq – në profesionet e pastrimit, shitjes, kujdestarisë, shëndetit e përkujdesjes. Janë kryesisht gratë ato që kujdesen për fëmijët, nipërit e mbesat, prindërit e moshuar dhe familjarëve të sëmurë. Për këto arsye ato punojnë pjesërisht dhe kanë të ardhura të ulëta. Në përgjithësi gratë fitojnë 33% më pak se burrat. Andaj ato aktualisht kanë pensione të ulëta e të padinjitetshme. Përderisa kjo nuk ndryshon, barazimi i moshës së pensionit qon në përkeqësim të situatës pensionale. Nuk vjen në pyetje që pikërisht gratë të paguajnë për reformën, e cila problemet e tyre i përkeqëson në vend se ti zgjidh.

Jo shkurtimeve sociale dhe moshës së pensionimit me 67 për të gjithë

AHV/AVS 21 anashkalon jo vetëm situatën pensionale të grave, por edhe realitetin e tregut të punës. Kush është përmbi 60 vjeç, s'mund të gjejë vend

pune më. AHV/AVS 21 do të dërgoi më shumë njerëz në papunësi afatgjate dhe në asistencë sociale – me pasoja të rënda ligjore për migrantët. Projektligji detyron Qeverinë Federale të paraqesë një reformë deri në vitin 2026, e cila ngritë moshën e pensionit për të gjithë. Një iniciativë tjetër e të rinjve liberal shkon edhe më larg, kërkon moshën e daljes në pension me 67 vjeç dhe tutje. Mirëpo jo vetëm pensioni i AHV/AVS është në shënjestër. Në shtyllën e dytë të pensioneve profesionale (fondi pensional) përmes BVG/LPP 21 na përballë me një shkurtime tjetër masakruës. Edhe këtu, në të ardhmen duhet të paguajmë me shumë për më pak pension. AHV/AVS 21 është vetëm etapa e parë. Vetëm një JO e qartë mund të ndryshojë drejtimin.

Kontribute më shumë – pension më pak?

Reforma është e gabuar edhe për faktin se ajo është ndërlidhur me ngritjen e TVSH për 0,4%. Ky financim shtesë

i pensioneve të AHV/AVS jo se është vetëm asocial. Në situatën aktuale do të ishte fatale, pasi që të ardhurat reale dhe fuqia blerëse edhe ashtu janë zvogëluar. Qysh tani janë rritur çmimet për mallra dhe shërbime. Ndërsa për vjeshtë është para programuar eksplodimi i premive të sigurimeve shëndetësore. Në këtë situatë të tendosur, parlamenti dëshiron të kalojë një parashtrësë, me të cilën ne të gjithë duhet të paguajmë më shumë – për pensione më të ulëta. Në një vend, ku ndërmarrjet shënojnë fitime në lartësi rekorde, ka mundësi me të mira, për të financuar pensionet më të mira të AHV/AVS-së!

Tani nevojitet një JO e dyfishtë për parashtrësën reduktuese AHV/AVS 21 dhe mbi ngritjen e TVSH-së. Shkurtimeve të pensioneve të AHV/AVS – dy herë JO. Duar larg nga pensionet tona!

Editorial



Të dashura kolege e kolegë

Sigurimi pensional i AHV/AVS është shtylla më e drejtë dhe e baraspeshuar e sistemit të sigurimit pensional. Veçanërisht për njerëzit, të cilët shkakun i rritjes së fëmijëve dhe përkujdesen për familjarë, kanë punuar pjesshëm dhe nuk kanë fond pensional (sigurim në shtyllën e dytë). Çdo e treta grua nuk ka sigurim pensional të shtyllës së dytë (fondit pensional) dhe duhet të aranzhohen vetëm me shtyllën e parë AHV/AVS, për të siguruar ekzistencën jetësore.

Vitin e kaluar AHV/AVS ka shënuar një fitim prej 2,6 miliarda. Kjo shtyllë nuk ka probleme strukturore, sikur pretendojnë politikanët e djathtë borgjez. Ata duan të bëjnë një reformë në kurriz të grave. Kjo është e padrejtë, pasi qon në humbje njëvjeçare të pensioneve. Kjo do tu kushtojë grave dhe familjeve të tyre 26000 franga në vit. Reforma është edhe një hap me tej drejtë moshës së pensionimit me 67 vjeç për të gjithë, edhe pse qysh sot 55-56 vjeçët eliminohen nga tregu i punës.

Gratë aktualisht marrin rreth 1/3 pension më të ulët se sa burrat. Ne, sikur deri me tani, kemi një dallim të dukshëm pagash prej 19%. Në vend se kjo padrejtësi të eliminohet, grave u duhet të paguajnë edhe më shumë.

Ngritja e moshës së pensionimit do të ketë ndikime të drejtpërdrejta në pensionet e tyre edhe ashtu më të ulëta. Gjithashtu do të ulen edhe pensionet e çiftëve. Paralelisht duhet të rritet tatimi në vlerën e shtuar. Ne qysh tani jemi të konfrontuar me një rritje presioni. Për shtator është planifikuar një rritje e fortë e premive të sigurimeve shëndetësore. Rritja e tatimit në vlerën e shtuar do të rëndojë së tepërmi amvisnit. Do të duhet të paguajmë më shumë dhe njëkohësisht të zbrisin pensionet tona. Kjo nuk është e pranueshme. Andaj, ne me 25 shtator do të votojmë 2 x JO përkitazi me rritjen e moshës së pensionimit dhe të tatimit në vlerën e shtuar.

Vania Alleva

News

«Un Soir Juste» (kujdesi korrekt): Shoqata te reja shëndetësore për më të varfrit të varfërve në Valisin frëngjisht folës.

Një lajm i mirë për punëmarrësit e pasigurte dhe familjarët e tyre: Sivjet për njerëzit në nevojë të madhe, pa sigurim shëndetësor, SansPapiers (persona pa status të rregulluar) edhe/ose të pastrehë, vlen oferta e re shëndetësore e konsultimeve pa pagese (apo pagesë simbolike 5 frangash). Në rast nevojë për infermier, këshilla të përgjithshme, psikiatri ose gjinekologji, furgoni i parkuar në parkingjet Verso l'Alto në Sion është i hapur një ditë në javë, me ose pa terminë. Më shumë informacion në faqen e internetit të shoqatës (në frëngjisht) <https://unsoirjuste.ch>.

SECO dhe Kantonet duhet të detyrojnë Uber për të respektuar ligjet

Vendimi Gjyqit Federal i datës 30 maj 2022 për Uber dhe Uber Eats kanë krijuar qartësi: Gjyqi Federal si instanca e fundit ka ardhur në përfundim se mes Uber dhe shoferëve e korrierëve të saj ekziston një marrëveshje pune. Uber mban të gjitha obligimet e një punëdhënësi: pagesa korrekte dhe me kohë e pagës, respektimin e pagave minimale dhe ligjit të punës, sigurimi i pajisjeve të punës, raport të saktë të shpenzimeve, dhënien e të së drejtave të pushimit, pagesën e kontributeve për aksidente dhe sigurime shoqërore. Unia për të satën herë u kërkon autoritetet kantonale të bëjnë punën e tyre. Ata përfundimisht duhet t'i japin fund punës sistematike të padeklaruar (në të zezë) në Uber. SECO (Sekretariati Shtetëror për Ekonomi), së bashku me Entin Federal të Sigurimeve Shoqërore (BSV), duhet të luajnë një rol aktiv dhe të koordinojnë aktivitetet e kantonëve për të siguruar që ato të zbatojnë në mënyrë efektive ligjin dhe mbrojtjen e punonjësve.

Fitore e pjesshme e punëtorëve të ndërtimit në kantieret e Gjenezës

Në Gjenezë në javët e fundit nga Unia janë vizituar përafërsisht 60 kantieret ndërtimi. Rreth 30 kallëzime janë paraqitur tek inspektorati i punës. Sindikata me kënaqësi vëren se mbrojtja shëndetësore për kantieret e ndërtimit po merret seriozisht. Sepse aty ku punon me asfalt të nxehtë 170 gradë, në vapë mbizotërojnë kushte çnjerëzore pune. Në fund të korrikut, pasi mori në pyetje punëtorët e ndërtimit, Unia Vaud pat dhënë alarmin. Sindikata kishte vërejtur mungesë uji në kantieret dhe se nuk kishte pauza në vapë të madhe. Dhe ajo kishte zbuluar se vetëm 8% e kantierëve të ndërtimit në kanton ishin mbyllur. Pas ndërhyrjes së Unia, disa punë ndërtimore gjatë orëve të nxehta janë ndërprerë. Unia ka mirëpritur vendimin e Inspektoratit të Paritetit të Punës në Gjenezë për të ndërprerë punën në orën 13:00 në një kantier ndërtimi.

Filiali i Migros-Daily në Cyrih duhet të dielave të mbyllet

Para tri vitesh lidhja kooperativiste Migros e Cyrihut kishte hapur në Zollstrasse një filiale Migros-Daily me shitje të dielave. Enti kantonal për ekonomi dhe punë kishte lejuar shitjen të dielave, pasi shitorja gjendej në afërsi të stacionit kryesor të trenit të Cyrihut. Mirëpo filiali në fjalë nuk gjendet në territorin e stacionit të trenit. Prandaj Unia nuk e konsideroi në rregull lejen dhe që në vitin 2019 ia arriti që të dielave dega Migros Daily duhej të qëndronte mbyllur. Gjykata nuk lejoi të mashtrohet nga veprimet e Migros dhe hetoi përpjekjen për të anashkaluar ndalimin e punës të së dielës duke vendosur personel sigurie. Në të njëjtën mënyrë tentohen edhe në vende të tjera në Zvicër për të minuar ndalimin e punës të dielave. Me vendimin tashmë të formës së prerë të gjykatës administrative në maj 2022, po i vjen fundi një mosmarrëveshje ligjore disavejeçare.

Përmirësime të KKP-ve

KKP më të mira dhe paga më të larta

Fillimisht lajmet e mira: Asnjë pagë nën 4000 franga për zejen e llamarinës (karrocerisë) dhe përkundrejt rritjes së pagave në zejen e floktarisë, megjithatë paga mbete e pamjaftueshme dhe kushtet e punës të vështira. Nevojiten zgjidhje që njerëzit të mos largohen nga zeja e floktarisë.

Hilmi Gashi

Unia në vazhdimësi lufton për kushte më të mira pune dhe paga më të larta. Që nga korriku për zeje e llamarinës (karrocerisë) një Kontratë e re Kolektive e Punës, e cila edhe nga qeveria federale është shpallur përgjithësisht e detyrueshme. Asnjë pagë nën 4000 franga dhe një rritje pagash prej 60 frangave për të gjithë ata, që fitojnë deri në 6300 franga në muaj. Për të rritur pagat në 4000 franga, pagat minimale janë ngritur për 350 franga. Përmirësime kemi edhe tek punonjësit e moshës mbi 58 vjeç. Për ta rishtas vlen afati 4 muaj për largim nga puna. Posa kontrata të shpallet me detyrim të përgjithshëm nga ana e qeverisë federale, Kontrata vlen edhe për ndërmarrjet, të cilat nuk janë të organizuara në Shoqatën e sipërmarrësve.

Paga më të larta minimale edhe për degën e floktarisë

Nga viti i ardhshëm do të rriten gjithashtu pagat minimale të floktarëve për 50 franga. Kjo rritje pagash është e pamjaftueshme

dhe duhet të bëhet më shumë, për të mos u larguar njerëzit nga kjo degë. Krahas pagave të pamjaftueshme edhe kushtet e punës në këtë degë janë të këqija dhe puna e vështirë. Floktarët përballen me substanca të dëmshme për shëndetin dhe ata punojnë shpesh pa pauza përgjatë ditëve të stërzgjatura të punës. Kjo qon deri në largimin e shumë prej tyre nga dega dhe tek një orientim i ri profesional.

Është më se e qartë që nevojitet një KKP më e mirë. Andaj për muajt e ardhshëm janë marrë vesh Unia dhe Shoqata e punëdhënësve të floktarisë «Coiffure Suisse» që të ri negociojnë KKP-në. Floktarët kërkojnë së bashku me Unia paga më të mira dhe kushte pune më të mira, të cilat atyre ua mundësojnë një balancë më të mirë mes jetës profesionale dhe asaj private.



Ushtrimi i profesionave në floktari e karroceri është i vështirë dhe me rreziqe për shëndetin

Hendeku i pagave

Pabarazia në rritje në Zvicër – duhen rritjet e përgjithshme të pagave

Studimi mbi hendekun e pagave të Unia tregon që pabarazia në Zvicër sa vjen e rritet. Shtrenjtimi krijon këtë problem. Rritje të përgjithshme të pagave janë më se të nevojshme.

Noémie Zurlinden, ekonomiste e Unia

Menaxherët dhe aksionarët e korporatave më të mëdha zvicerane pasurohen

Në studimin e hendekut të pagave, Unia tregon se pabarazia në paga në korporatat më të mëdha zvicerane është rritur. Mesatarisht, menaxherët fituan 141 herë më shumë në vitin 2021 sesa punonjësit me pagat më të ulëta në të njëjtën kompani. Në vitin 2020 ishte 136 herë më shumë.

Përveç kësaj, korporatat shpërndanë një total prej 42 miliardë frangash në dividendë për aksionarët e tyre. Për më tepër, 40 miliardë u shpenzuan për blerjen e aksioneve – 56% më shumë se në vitin 2020.

Rritja e pabarazisë në paga edhe në nivelin e përgjithshëm ekonomik

Pabarazia nuk po rritet vetëm në ndër-

marrjet më të mëdha, por në tërë Zvicrën. 10% e pagave më të ulëta mes viteve 2016 dhe 2020 praktikisht ngecën, ndërsa pagat e menaxherëve të lartë u rritën me 12%. Pagat mesatare gjithashtu pothuajse nuk u zhvilluan fare, edhe pse punonjësit ishin më produktivë. Nëse merrret parasysh shtrenjtimi, madje ka ngecur edhe paga mesatare – kështu që prej vitesh fuqia blerëse e punonjësve nuk është rritur fare.

Rritja e përgjithshme e pagave është e nevojshme për të zbutur pasojat e shtrenjtimit

Nëse sivjet nuk rriten pagat, veçanërisht punonjësit me të ardhura të ulëta dhe të mesme, për shkak të rritjes së inflacionit dhe rritjes së pritshme të primeve të sigurimit shëndetësor, do ta kenë më të vështirë përballimin.

Për të zvogëluar pabarazinë në rritje të pagave në korporatat më të mëdha zvicerane dhe në ekonominë në tërësi, rritja e përgjithshme e pagave është e nevojshme. Pas rimëkëmbjes së fortë ekonomike pas krizës së koronës, ndërmarrjet duhet të përmbushin përgjegjësinë e tyre sociale – jo vetëm përgjegjësinë e tyre ndaj aksionarëve.



Hendeku i pagave dhe pabarazia në Zvicër sa vjen e po rritet

1 Tetori: dita ndërkombëtare e njerëzve të moshuar

Për një jetë në dinjitet për njerëzit e moshuar!

Në kuadër të «Ditës ndërkombëtare të njerëzve të moshuar» me 1 tetor shtrohet pashmangshëm pyetja se cilat janë probleme dhe nevojat që kanë njerëzit e moshuar në Zvicër dhe Evropë. FERPA (Federata Evropiane e Pensionistëve dhe të Moshuarve) numëron në një MANIFEST nevojat dhe tregon hendeqet, të cilat duhet të mbyllën.

Paola Ferro, Dario Mordasini, delegatë të Unia në FREPA

Numri i njerëzve të moshuar në Evropë sa vjen e rritet. Vetëm në Zvicër rreth 2,5 milion njerëz marrin pension pleqërie të AHV/AVS. Nuk është për tu habitur, që shumë tema aktuale, tek të cilat Unia lufton në rresht të parë, mos të kenë një ndërlidhje me pleqërinë (kujdesi, pensionet etj.)

MANIFESTI për të drejta të njerëzve të moshuar

Nën shenjën e pandemisë, FREPA – edhe nën ndikimin e Unia – në manifestin e saj ka bërë një inventar të situatës aktuale në nivel evropian dhe ka pasqyruar nevojat e njerëzve të moshuar: luftimi i të gjitha formave të varfërisë; e drejta për pensione korrekte duke marrë parasysh veçoritë

specifike gjinore; e drejta për qasje afatgjate të kujdesit korrekt shëndetësor për të gjithë; e drejta për banim të shëndetshëm dhe korrekt; e drejta për përfshirje sociale dhe pjesëmarrja e pakufizuar e njerëzve të moshuar në jetën sociale, politike e kulturore në kuptimin e ndër gjeneratave. Ky dokument i rëndësishëm ndër të tjera iu është parashtruar institucioneve evropiane.

Luftimi i varfërisë në pleqëri

Në Zvicër nga varfëria janë të prekur pasasëgjithash pensionistët, e veçanërisht gratë. Shumë njerëz duhet të përdorin shërbime për përfitime shtesë për të përballuar jetesën. Me kthimin e inflacionit, po sillt edhe fantazma e varfërisë ener-

gjetike dhe në muajt e ardhshëm faturat e larta të korrentit do të rëndojnë rëndë buxhetet e pensionistëve. Gjithashtu, problemet e përshkruara prekin e sfidojnë edhe migrantet e migrantët që kanë arritur ose do të arrijnë moshën e pensionit në vitet e ardhshme.

Pra, ka shumë arsye për të mbështetur përpjekjet e lëvizjes sindikale zvicerane për të përmirësuar shtyllën e parë të pensioneve (AHV/AVS) dhe atë të dytë. Qëllimi është t'u mundësohet të gjithë grave dhe burrave të moshuar, pavarësisht nga vendi i origjinës, të jetojnë me dinjitet.

Lexoni MANIFESTIN në vijim: Ferpa's Manifesto – Ferpa



Aksione të ndryshme të ndikuara e të mbështetura nga Unia kundër varfërisë në pleqëri

Java e aksionit kundër AHV/AVS 21

Demokracia në vendin e punës

Sindikatat domethënë edhe pjesëmarrje, pavarësisht nga pasaporta. Unia si organizata më e madhe e migrantëve në Zvicër, ka vendosur, që ti jep të drejtë vote secilit punëmarrës, të cilët nuk mund të marrin pjesë në votimet e 25 shtatorit, për të ndaluar shkurtime reformuese të AHV/AVS 21. Projekti i prek ata personalisht, andaj do të ishte e drejtë, të kenë një të drejtë bashkëvendosjeje.

Mattia Lento

Nga 22 deri 27 gusht 2022 sindikata Unia e Tiçino dhe Moesa në kuadër të javës së aksionit kundër AHV/AVS 21 zhvilloi një këshillim me të varurit nga paga, për të pasur mundësi që edhe këta të shprehen për këtë çështje të rëndësishme. Në titullin «Demokracia në vendin e punës: Dëgjimi i punëmarrësve mbi reformën AHV/AVS 21», janë përfshirë veçanërisht punëmarrëset femra, të cilat janë të prekura më së shumti nga AHV/AVS 21.

Përse Jo për AHV/AVS 21

Reforma AHV/AVS 21 donë që ti obligojë gratë të punojnë një vit më gjatë dhe tua heq atyre 2600 franga pension: Kjo është një flakaresh në fytyrë të grave punonjëse nga ana e taborit borgjez deh shoqërive të sigurimit, të cilat synojnë një sistem të mundshëm privatizues të pensioneve. Qysh tani nuk mjaftojnë për të jetuar pensionet, posaçërisht për gratë. Shkaku i punës së pjesshme dhe pabarazisë në paga, gratë në thelb marrin pensione më të ulëta. Rreth çereku i grave pas daljes në pension jeton vetëm nga pensioni i AHV/AVS. Shumë nga to janë të detyruara të jetojnë në varfëri. Zgjidhja do të ishte, fuqizimi i shtyllës së parë. Mirëpo në vend të kësaj parlamenti dëshironte kursejë 7 miliardë franga në kurriz të grave. Këto shkurtime të pensioneve të AHV/AVS prekin edhe burrat. AHV/AVS 21 është pjesë e hapit të parë në drejtim të ngritjes së përgjithshme të moshës së pensionimit në 67 vjeç apo edhe më shumë për të gjithë. Ngritja e moshës së daljes në pension

nuk bie zgjidhje, përkundrazi dënon njerëzit në papunësi dhe në ndihmë sociale.

Mbi të gjitha konferenca ishte një pikëpamje interesante mbi Evropën, e cila ofron hapësirë për më shumë bashkë formësim social.



Aksione të ndryshme të ndikuara nga Unia kundër varfërisë në pleqëri

Intervista «Pjesëmarrja në demokraci».



Mbi demokracinë, deficitet e demokracisë dhe rolin e Unia, me Hilmi Gashin, drejtues i grupeve të interesit në Unia, foli Emine Sariaslan.

Çka është demokracia sipas pikëpamjes tënde?

Demokracia definohet si një formë e jetës politike, në të cilën do të duhej të sundonte populli. Ajo mund të ketë forma të ndryshme. Zgjedhja e një parlamenti, i cili më pas në emër të popullit aprovon ligje, është forma më e shpeshtë. Në disa demokraci, popullata ka disa instrumente dhe mundësi ndikimi, si fjala bie e drejta e referendumit apo e një plebishiti popullor.

A munden në një demokraci të bashkëvendosin që të gjithë?

Mjerisht jo. Shpesh ndodh ajo, që një shumicë vendos se kush do të zgjidhet në parlament dhe cilat ligje duhet të vlejnjë për të gjithë. Pakicat, kryesisht migrantët, mirëpo edhe të rinjtë nën 18 vjeç apo njerëzit me kufizime psikike shpesh përjetojnë kufizime dhe zëri i tyre nuk dëgjohej. Atyre, nga ana e një shumice u refuzohet e drejta për bashkëvendosje politike, sikur tregojnë shumë votime mbi të drejtën e votës dhe zgjedhjes së të huajve në shumë kantone të Zvicrës.

Sie është puna në Zvicër?

Zvicra ka demokracinë e drejtpërdrejtë. Kjo mundëson më shumë fuqi krijuese, mirëpo vetëm për njerëzit me privilegjin e të drejtës së votës dhe zgjedhjes. Vetëm shtetasit e Zvicrës mund të zgjedhin parlamentin, të përdorin referendum kundër ligjeve dhe të nisin iniciativa: Kështu një çerek i popullsisë përjashtohet nga demokracia. Migrantët, edhe nëse janë lindur e rritur këtu dhe që njohin shumë mirë sistemin, as mund të zgjedhin parlamentin e as mund të mbrohen nga ligjet diskriminuese apo ndryshimeve kushtetuese. Këtë fat të migrantëve deri në vitin 1971 e kanë përjetuar edhe gratë në Zvicër. Tek para 51 viteve votuesit burra të Zvicrës ua kanë pranuar të drejtën e votës dhe zgjedhjes grave. Mirëpo, tek pas një lufte të gjatë të grave për të drejtat e tyre.

Çka duhet të ndryshojë?

Migrantët japin një kontribut të rëndësishëm për mirëqenien e shoqërisë në aspektin kulturor e ekonomik. Ata paguajnë taksa, mirëpo nuk mund të bashkëvendosin, se si duhet të përdoren ato taksa. Ata paguajnë kontribute në sigurimet shoqërore, mirëpo nuk mund të votojnë, se a pajtohen me rritjen e moshës së daljes në pension të grave apo të tatimit në vlerën e shtuar. Ata kanë obligime, por jo të drejta. Kjo nuk është e denjë për një demokraci, pasi me kushtetutën e Zvicrës fuqia e popullit matet me mirëqenien e të dobëtëve. Një demokraci, e cila çerekun e popullatës e përjashton nga bashkëvendosja politike, nuk është demokraci e plotë.

Çfarë roli luan Unia me këtë rast?

Unia është një organizatë e fuqishme, fale edhe migrantëve dhe faktit, se të gjithë – pavarësisht ngjyrës së pasaportës në Unia drejtpërdrejtë mund të bashkëkrijojnë dhe bashkëvendosin. Kjo është forca jonë. Mirëpo, jo të gjithë në Unia janë ithtarë të së drejtës së votës dhe zgjedhjes për migrantët. Ne këtu duhet të bëjmë një punë më rëndësi dhe ti përfitojmë kolegët tanë zviceran, që bashkë me ne migrantët që të angazhohen aktivisht me rastin e një iniciative të mundshme. Në manifestimin tonë «S'ka demokraci pa pjesëmarrje të migrantëve» me 24 shtator 2022, ne kemi ftuar të gjithë përfaqësuesit e grupeve të interesit për të bashkëbiseduar dhe për të zhvilluar ide se si ne mund të forcojmë demokracinë. Lufta emancipuese e grave do të duhej të na inspironte, sikur edhe manifesti i aksionit «Vierviertel» (katër çereku).

Vega e manifestimit: <https://bit.ly/3wC8Hqt>

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Borxhet: A ka të drejtë Arka e Papunësisë mëditjet e mija t'ia paguajë zyrës përmbaruese?

Unë jam i papunë dhe kam borxhe. Zyra përmbaruese ka ndërmarrë një sekuestrim të pagës, gjegjësisht të mëditjeve. Çka do me thënë kjo saktësisht? Dhe a ka të drejtë Arka e papunësisë që mëditjet e mija t'ia bartë drejtpërdrejtë zyrës përmbaruese?

Nicole Debrunner: Po. Sekuestrimi i pagës domethënë se, ajo shumë që nga paga e juaj kalon minimumin jetësor, në vend se juve punëdhënësi ia bartë direkt zyrës përmbaruese. Minimumi jetik vendoset nga zyra përmbaruese dhe është e detyrueshme. Sekuestrimi i pagës lejohet të zgjat më së shumti një vit. Nëse borxhet brenda kësaj kohe nuk janë larë, kërkuesi i borxhit mund të kërkoi vazhdimin e kohës të sekuestrimit. Kështu sekuestrimet e pagës mund të zgjatën më shumë se një vit. Pasi që ju merrni kompensimin e papunësisë, arka e juaj e papunësisë dallimin mes kompensimit të papunësisë dhe minimumit ekzistencial ia paguan drejtpërdrejtë zyrës përmbaruese. Ju edhe ë tutje do t'ju paguhet vetëm shuma e paraparë për të siguruar ekzistencën. Zyra përmbarues di ti përdorë paratë për të paguar pjesërisht apo tërësisht borxhin që ju keni. Nëse ju merrni vetëm një pjesë të mëditjeve mujore, minimumi jetik nuk do të përshtatet proporcionalisht. Sekuestrimi i të ardhurave përfshinë ekskluzivisht vetëm pjesën e pagës që tejkalon minimumin ekzistencial.

(Work, 1.7.22)

Divorci: A ka të drejtë arka e papunësisë që të transferojë paratë e mirëmbajtjes direkt ish-gruas?

Unë jam i papunë dhe në mes të divorcit. Gjyqi në procedurën e divorcit me ish-partnerin time ka nxjerrë urdhërese për masa paraprake: Të gjitha pagesat dhe kompensimet që më takojnë mua, ajo pjesë e të ardhurave të mia që tejkalojnë nivelin tim ekzistencial, duhet t'i paguhen deri në një shumë maksimale ish-partneres time. Shuma maksimale korrespondon me shumën e mirëmbajtjes për familjen time. Në veçanti, zbritja duhet të bëhet nga të gjithë përbërësit e pagës sime, shtesat dhe kompensimet e mia. Ish-partnerja ime tani i ka kërkuar arkës së sigurimit të papunësisë që t'i dërgojë asaj drejtpërdrejtë pagesat e mirëmbajtjes. A do ta bëjë këtë arka e papunësisë?

Nicole Debrunner: Po. Ish-partnerja juaj ka paraqitur një kërkesë në arkën e sigurimit të papunësisë për pagesën e përfitimeve të vazhdueshme tek një palë e tretë (ish-partneres suaj). Ekziston një urdhër gjyqësor që thotë se debitorët tuaj duhet të transferojnë pagesat aktuale deri në një shumë të caktuar të ish-partnerja juaj. Arka e sigurimit të papunësisë është një nga debitorët tuaj në kuptimin e vendimit gjyqësor dhe madje përmendet shprehimisht në të. Për sa kohë që urdhri është i vlefshëm, arka e sigurimit të papunësisë duhet t'ia transferojë përfitimim aktual të papunësisë drejtpërdrejtë të ish-partnerja juaj, me kusht që të tejkalojë shumën e nevojshme për mbijetesë, deri në shumën maksimale të specifikuar në muaj. Arka e sigurimit të papunësisë do të kontrollojë rregullisht nëse urdhri është ende i vlefshëm. Megjithatë, këshillohet që për të gjitha ndryshimet të informoni menjëherë arkën në mënyrë që pagesat të bëhen në shumën korrekte. Përfitimet e papunësisë deri në nivelin e shumën për mbijetesë si dhe ato që mbeten pas pagesës së shumës së mirëmbajtjes, do të vazhdojnë t'ju paguhen juve drejtpërdrejt.

(Work, 1.7.22)

Puna të dielave për prindër: Çka vlen në gastronomi?

Burri im dhe unë, që të dy, punojmë në kioskën e stacionit të trenit. Atje secili prej nesh deri më tani praktikisht kemi pasur nga një të diele në muaj të lirë. Tani burri im donë të ndërrojë vendin e punës dhe të kaloj në gastronomi. Një mik, i cili tanimë punon aty, i ka thënë burrit tim, se ai do të ketë vetëm katër të diele në vjet të lirë. Derisa ne dy kemi edhe fëmijë në shkollën obliguese, unë dua që burri im edhe më tej të ketë një të diele në muaj të lirë. A mundet ai të kërkoi një gjë të tillë?

Myriam Muff: Po. Bazuar në urdhëresën 2 mbi ligjin e punës punonjësit e gastronomisë, prindërit që janë përgjegjës për rritjen e fëmijëve kanë të drejtë në së paku 12 të diela të lira në një vit kalendarik. Prindërit me fëmijë deri në moshën 15 vjeç konsiderohen përgjegjës për rritjen e fëmijëve. Nëse miku i burrit tuaj merr vetëm katër të diela pushim në vit, ka të ngjarë që ai të mos ketë fëmijë ose të ketë fëmijë mbi moshën 15 vjeç. Në një rast të tillë, lejohet që punonjësi t'u jepet vetëm katër të diela pushim në vit. Me kusht që të mos kenë nevojë të punojnë mesatarisht më shumë se pesë ditë në javë. Nga ana tjetër, për ju si punonjës në kioskën e stacionit nuk ka rëndësi sa vjeç janë fëmijët tuaj. Në ndryshim nga punonjësit e gastronomisë, ju keni gjithmonë të drejtën e dymbëdhjetë të dielave pushim në vit – pavarësisht nëse keni detyrime prindore apo jo.

(Work, 19.8.22)

Mattia Lento kandidat në zgjedhjet e 25 shtatorit 2022

Më 25 shtator, Italia do të zgjedhë një parlament të ri

Në krahasim me Kosovën dhe Shqipërinë që gjithashtu kanë një diasporë të madhe, Italia sikur edhe disa vende tjera të BE-së kanë të rregulluar dhe të garantuar me ligj të drejtën e përfshirjes dhe përfaqësimit përmes votës demokratike të diasporës me tre euro-deputetë në Parlamentin e vendit.

Osman Osmani

Italianët që jetojnë jashtë mund të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Parlamentin italian. Njëri nga 3 kandidatët që tërheqë vëmendjen e komunitetit shqiptar të Zvicrës është aktivisti i mirënjohur i gjelbër, Mattia Lento. Mattia Lento është një gazetar i përkushtuar që merret me çështje që kanë të bëjnë me pakicat shqiptare edhe të Kosovës në Zvicër.

Me rastin e kandidaturës, në një prononcim për prointegra.ch dhe komunitetin shqiptaro-zviceran ai theksoi: «Kandidojë për Sinistra italiana / Europaverde (Evropa e gjelbër) për Kuvend në zonën elektorale Evropa. Ne zgjedhim 3 euro-deputetë në Evropë: kemi shanse për vendin e tretë (njëri shkon qartë për PD-në, e cila është aleate me ne në Itali kundër së djathtës), një në të djathtë (post-fashistët, Lega dhe Berlusconi) dhe i ulësja e tretë. është ende e hapur se kush do ta fitojë. Në Senat zgjedhim vetëm një deputet, ndaj nuk bëme listë për të mos favorizuar të djathtën (ne mbështesim listën e PD). Të gjithë të rriturit që jetojnë jashtë Italisë dhe në një vend evropian dhe me pasaportë italiane janë votues të mundshëm. Fletët e votimit me të gjitha të dhënat për votim jashtë vendit do të mbërrijnë me postë në fillim të shtatorit.»

Si gazetar, Mattia është shumë i ndjeshëm ndaj të drejtave të pakicave në Zvicër. Ai, përpos shkrimeve sindikaliste për botën e punës, ka shkruar edhe një numër të kon-



ELEZIONE 2022
della Camera dei Deputati
Circoscrizione Estero - Europa

«Per una
giustizia sociale
senza confini»

Vota:
Mattia Lento
Croce sul simbolo e scrivi
LENTO



siderueshëm artikujsh në qendër të cilave janë preokupimet, shqetësime dhe nevojat e komunitetit tonë në Zvicër por edhe dashamirëse për Kosovën e Shqipërinë dhe atë në gjermanisht, italisht e frëngjisht.

Ftojme, qysh tani, të gjithë bashkëkombësit shqiptaro-italian dhe shqiptaro-evropian si dhe kolegët tanë me të drejtë vote në Itali dhe vendet e BE-së që të votojnë për Mattia Lento!

Të tjerët për Mattia Lento

Mattia Lento, si veprimtar i dalluar për migrantët dhe grupet e marginalizuara, natyrisht se për kandidaturën e tij ka marrë përkrahje të gjerë nga grupet dhe partitë e majta dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut

dhe me mbrojtjen e migrantëve dhe azil-kërkuesve dhe personave pa letra. Kështu shprehet veprimtarja e AL (subjekti Lista Alternative) të Cyrihut, Manuela Schiller: «Nisur nga profili, ishte e natyrshme që lideri i Evropës së Majtë-Gjelbër italiane të nominonte Mattia-n si kandidat për zgjedhjet e ardhshme të 25 shtatorit. Pasi Mattia e mendoj dhe u përball me partnerin e tij, ishte e natyrshme që ai do ta pranonte. Për Mattia-n, është një zgjedhje e angazhimit qytetar, në një kohë kur politika është në krizë të thellë, të kandidojë. Mattia-do të mund të kontribuon dhe të vë në praktikë të gjithë përvojën e tij si njeri i shoqatave. Jam i sigurt se shumë prej nesh do ta mbështesin atë në këtë sfidë të re.» thekson ajo.

Marrëveshja për pensione mes Zvicrës dhe Shqipërisë

Njoftimi mbi Marrëveshjen e Sigurimeve Shoqërore me Shqipërinë

Marrëveshja e re dypalëshe formalizon marrëdhëniet e sigurimeve shoqërore midis Zvicrës dhe Shqipërisë. Ajo mbulon sigurimet për moshën e tretë, si dhe për mbijetuesit dhe invalidët, dhe përputhet me standardet ndërkombëtare për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore.

Osman Osmani

Siç njofton zyrtarisht qeveria zvicerane, në mbledhjen e saj të datës 24.08.2022 në Bernë ka aprovuar dërgimin në parlament të Marrëveshjes mbi sigurimet shoqërore të Zvicrës dhe Shqipërisë. Kjo marrëveshje rregullon sigurimin e kujdesit të pleqërisë, trashëgimisë dhe invaliditetit të shteteve kontraktuese dhe rregullon pagesën e pensioneve jashtë vendit. Me këtë mbështeten edhe marrëdhëniet ekonomike të Zvicrës me Shqipërinë.

Përmbajtja e marrëveshjes është në përputhje me marrëveshjet tjera të sigurimeve shoqërore të lidhura nga Zvicra dhe orientohet në standardet ndërkombëtare të koordinimit të sistemeve të sigurisë sociale. Marrëveshja koordinon përkujdesjen e pleqërisë, trashëgimtarëve dhe invaliditetit, në mënyrë që pjesëtarët e të dyja shteteve të mos mund të disfavorsizohen apo diskriminohen. Rrjedhimisht, marrëveshja siguron një trajtim të gjerë të barabartë të të siguarve, rregullon pagesën e pensioneve jashtë vendit dhe mënjanton tarifën e dyfishtë. Marrëveshja gjithashtu ofron një bazë për të luftuar keqpërdorimin në të dyja vendet.



Marrëveshja është negociuar mes shteteve kontraktuese dhe është nënshkruar me 18 shkurt 2022. Për tu fuqizuar, ajo fillimisht duhet të miratohet nga parlamentet e shteteve kontraktuese.